



**AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS
MARUBI**

Nr. prot. 195

Tiranë, më 18.09.2023



**AUTORITETI PËR INFORMIM MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHETITIT
(AIDSSH)**

Nr. prot. 1566

Tiranë, më 14.09.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, më datë 12.09. 2023, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

- 1. Akademia e Filmit dhe Multimedias “Marubi”,** Tiranë, e përfaqësuar nga Z. Kujtim Çashku, Drejtori i Akademisë së Filmit dhe Multimedias “Marubi”.
dhe
- 2. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH),** përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

Palët janë marrë vesh se për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

NENI 1

Qëllimi

- 1.1 Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit hartojnë këtë Marrëveshje me qëllim:**
 - a. informimin dhe të ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë, lidhur me periudhën e errët të krimeve të komunizmit të kryera nga strukturat e ish sigurimit të Shtetit;
 - b. Nxitjen dhe promovimin së bashku të punës kërkimore-shkencore dhe të mendimit analitik në funksion të demokracisë përmes kulturës së imazhit;
 - c. Rritjen e interesimit të kuptimit publik e në mënyrë të veçantë tek brezat e rinj, për njohjen më të mirë të së kaluarës por dhe të funksioneve të institucioneve demokratike dhe atyre arsimore në kuadër të zbatimit të legjislacionit të tanishëm në fuqi;
 - d. Vendosjen e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe kontributi në njohjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet dhe historitë e komunizmit, për edukimin e brezave të rinj dhe zhvillimin e dialogut të shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

NENI 2

Objekti i Marrëveshjes

2.1 Kjo Marrëveshje bashkëpunimi ka si objekt:

- a. Bashkëpunimin midis dy institucioneve të lartpërmendura në fushën e shkëmbimeve të informacionit dhe të dokumentacionit, si dhe të aktiviteteve të përbashkëta në vijim të botimeve që burojnë nga këto dokumente;
- b. Institucionalizimin e marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste;
- c. Bashkëpunimin në fushën e materialeve digjitale, rubrikave mediatike, online, videove sensibilizuese, dëshmime gojore, të botimeve, etj., mbi kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet e diktaturës dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit.

NENI 3

Baza ligjore

- Ligji Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (i ndryshuar);
- Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Ligji nr. 80, datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr. 93, datë 27.02.2019 “Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;
- Vendimi nr. 229, datë 26.04.2018 Për riorganizimin e Shkollës së Lartë Jopublike, Marubi në Akademi të Filmit dhe Multimedias Marubi dhe dhënien e Statusit të Veçantë këtij institucioni të Arsimit të Lartë”;
- Rregullore e AIDSSH “Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, miratuar me Vendimin nr. 21, datë 09.05.2017 të Autoritetit;
- Rezoluta nr.11 “Për dënimin e krimeve të kryera nga regjimi komunist në Shqipëri” (2006) të Kuvendit të Shqipërisë;
- Rezoluta e Parlamentit Europian mbi rëndësinë e një kujtese të përbashkët europiane (2019) dhe parimet e Rrjetit Europian të Kujtesës dhe Solidaritetit.

NENI 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

4.1 Në përmbushje të kësaj Marrëveshjeje, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi dhe AIDSSH kanë të drejta e detyrime dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misionëve të tyre, si më poshtë:

4.1.1 Të drejtat dhe Detyrimet e Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi i ofron Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit:

- a. Bashkëpunim në organizimin e konferencave, seminareve dhe veprimtarive kulturore e kinematografike të këtij lloji me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për çështje me interes publik;
- b. Pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentor pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përmes ekspertizës profesionale për çështje të ndryshme me interes publik, apo projekte që lidhen me fushën e veprimtarive që kryen Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi;
- c. Pjesëmarrjen me analiza, punime të përbashkëta në projekte kërkimore të organizuara në bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- d. Ndihmë dhe mbështetje teknike e profesionale në organizimin e workshop-eve profesionale dhe konferencave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- e. Mundësinë për të pasur akses në produksionet më të reja të Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi, si dhe në punimet shkencore dhe krijimet artistike të stafit të saj akademik, në respekt të legjislacionit në fuqi dhe të rregulloreve të brendshme të Akademisë Marubi.
- f. Dhënien e asistencës profesionale në filmimin dhe montimin e dëshmimeve gojore, si dhe pajisjet përkatëse;
- g. Bashkëpunim në përgatitjen e medias për grupmoshat e vogla dhe të reja;
- h. Asistencën me vlerësimin e aspektit teknik të materialeve filmike në RTSH, ATSH dhe AIDSSH, duke analizuar cilësitë e tyre dhe identifikuar pajisjet e proceset e digjitalizimit të tyre;
- i. Vënien në dispozicion të Autoritetit, filmime, foto të të burgosurve politikë, foto të tjera që lidhen me natyrën e punës së Autoritetit;

4.1.2 Të drejtat dhe detyrimet e AIDSSH

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit i ofron Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi:

- a. Mundësinë për të bashkëpunuar në procesin e hartimit të programeve edukuese nëpërmjet ekspertizës, konsultave dhe dëgjësave të programuara me të gjitha kategoritë e njësive arsimore, ashtu sikurse dhe kërkimeve-shkencore, për pedagogët, ekspertët dhe studentët e fushave të ndryshme;
- b. Mundësinë për të kontribuar e koordinuar aspekte teknike që lidhen me fushën e teknologjisë digjitale dhe filmike me specialistët e saj dhe pedagogët dhe ekspertët e Akademisë së Filmit dhe Multimedias Marubi;
- c. Bashkëpunimin në organizimin e konferencave, seminareve dhe veprimtarive të tjera të këtij lloji për aktivitete e çështje me interes publik;
- d. Ndihmë profesionale dhe bashkëpunim për veprimtaritë e organizuara nga Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi, në aktivitete që kanë në fokus të drejtat e njeriut, siç është dhe Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (IHRFFA) organizuar prej saj;
- e. Mundësinë që studentët e Akademisë Marubi të kryejnë praktika mësimore pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;
- f. Informacion dhe orientime gjatë procesit të hartimit të tezave të diplomës dhe të disertacioneve që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit;

- g. Pjesëmarrjen e stafit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit në projekte kërkimore të organizuara nga Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi;
 - h. Bashkëpunim i ndërsjelltë në vënien në dispozicion të dokumenteve të kërkuara si dhe për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Akademisë së Filmit Marubi.
- 4.2 Palët në këtë Marrëveshje angazhohen të përdorin pa pagesë, hapësirat e ndërsjellta, për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

NENI 5

Pronësia intelektuale

- 5.1 Pronësia intelektuale (intervista, dëshmi, filma, etj.) e zotëruar nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi. Pronësia intelektuale e krijuar si rezultat i bashkëpunimit sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jetë në pronësi të përbashkët e të dyja palëve.
- 5.2 Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet (në çfarëdo lloj forme qofshin) në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për një periudhë kohe 1 (një) vjeçare të rinovueshme automatikisht (Neni 8).

NENI 6

Bashkëpunime midis dy institucioneve

- 6.1 Marrëveshja krijon bashkëpunim në nivele institucionale dhe të kërkimit, lehtëson aksesin në dokumentacionin dhe në aktivitete të përbashkëta, në rastin e organizimeve studimore apo botimeve dokumentare që lidhen me dokumentacionin historik të shtetit shqiptar, si dhe krijon bazën e bashkëpunimit midis stafëve, duke përfshirë punonjësit dhe kërkuesit shkencorë të të dy institucioneve në projekte e aktivitete të përbashkëta që lidhen me fokusin e tyre.

NENI 7

Bashkëpunimi në fusha të tjera

- 7.1 Në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit janë të gatshëm të bashkëpunojnë në çdo kohë dhe ta shtrijnë këtë bashkëpunim në të gjitha fushat për të cilat shfaqin interes të përbashkët dhe bien dakord.

NENI 8

Afati i Marrëveshjes

- 8.1 Marrëveshja ka kohëzgjatje 1 (një) vjeçare. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur për vitet pasardhëse.
- 8.2 Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë nga secila Palë, nëpërmjet njoftimit me shkrim të paktën një muaj përpara.
- 8.3 Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin prej informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.


NENI 9

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

- 9.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
- 9.2 Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Akademinë e Filmit dhe Multimedias Marubi dhe dy të tjera depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit.

**PËR
AKADEMINË E FILMIT
DHE MULTIMEDIAS MARUBI**

Z. KUJTIM CASHKU



**PËR
AUTORITETI PËR INFORMIM
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHETIT**

ZNI. GENTIANA SULA

